



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

02.09.2024, Prishtinë,
Ref:24.07.2024\1546-2024

**Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj
ankesës së Vudi Xhymshiti kundër Nacionale.com dhe
Gazetaexpress.com**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e
tij të mbajtur më 27 gusht 2024, shqyrtoi ankesën e dërguar
nga Vudi Xhymshiti kundër Nacionale.com dhe
Gazetaexpress.com lidhur me publikimin e disa shkrimeve,
dhe mori këtë

V E N D I M

- Ankesa nuk miratohet.

A R S Y E T I M

Mediat kanë publikuar artikuj, në të cilët përmendet ankuesi, i cili pretendon se bien ndesh me kapitujt I (dispozitat e përgjithshme), II (raportimi i së vërtetës), III (nxitja dhe gjuha e urrejtjes) dhe VII (privatësia) të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës.

Lajmet janë të publikuara në mediat online dhe objekt i kësaj ankese janë tekstet e shkruara, rrjedhimisht ankesa është e lejueshme për trajtim dhe e afatshme.

Pas shqyrtimit të ankesës, KMSHK gjen se ankesa është e pabazuar. Pra, nuk miratohet.

Pas leximit të ankesës dhe pretendimeve të saj, si dhe shkrimeve të mediave KMSHK ka gjetur se raportimi i mediave ka qenë i drejtë, sepse pas reagimeve nga ankuesi, media në Bosnjë dhe Hercegovinë e ka cituar atë në një shkrim të radhës. Në lidhje me këtë pikë mediat e kanë kryer punën e tyre në raportimin e së vërtetës, pasi që kanë njoftuar publikun përkitazi me raportimet e palëve të treta në lidhje me mediat në Kosovë.

Në lidhje me nxitjen e urrejtjes, KMSHK nuk gjen prova në shkrimet e mediave se kanë nxitur urrejtje kundrejt ankuesit. Fakti që kanë përmendur atë si burim informacioni për median boshnjake nuk e bën të cënueshëm në asnjë formë të nxitjes së urrejtjes.

Në lidhje me privatësinë dhe mbrojtjen e burimeve, KMSHK konsideron se nuk është zbuluar asnjë burim i gazetarisë, thjesht janë cituar vetëm ato që mediumi boshnjak i ka raportuar.

Në lidhje me çështjen e ankuesit me Ministrinë e Kulturës, KMSHK ka marrë vendim më herët.

Në lidhje me shkrimin e cituar nga media për ankuesin dhe emisarin amerikan Gabriel Escobar, po ashtu KMSHK ka marrë vendim më herët.

Andaj, KMSHK vendos që ankesa të mos miratohet.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës